VENDIM
Nr. 61, datë 19.4.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENERGY 24" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.4.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Energy 24" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Energy 24" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- Shoqëria "Energy 24" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 273 prot., datë 4.4.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë "Energy 24" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "d" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), germa "e" (struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca), neni 9, pika 3, germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- dokumentacionin teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa "b" (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti).

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Energy 24" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti